



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

KËRKESË

Drejtuar:

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Sot, më datë 1 shkurt 2025, ne, përmbaruesit gjyqësorë privatë, anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë (DHKPGJP), si përfaqësues të shumicës së vullnetit të saj, nga kjo mbledhje solemne, i drejtohem Kuvendi të Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke kërkuar vëmendje maksimale në shqyrtimin e nismës së propozuar nga një deputete e Kuvendit të Shqipërisë, e cila synon ndryshimin e Kodit të Procedurës Civile.

Duke qenë se nisma legislative e 31.12.2024 “Për decentralizimin e urdhrit të ekzekutimit” prek, mes të tjerash, një nga hallkat më të rëndësishme të procesit të ekzekutimit, themelin e sigurisë juridike dhe efektivitetin e drejtësisë në vend, kërkojmë nga Komisioni:

1. Të zhvillojë, pa humbur kohë, konsultime gjithëpërfshirëse, sipas detyrimit ligjor për transparencën dhe përfshirjen e aktorëve të prekur nga ky ndryshim thelbësor në legjislacionin procedural civil.
2. Të sigurojë që çdo ndryshim i propozuar të mos jetë eksperimental, por të bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare, në modelet më të suksesshme dhe sa më pranë realitetit shqiptar, si ai i provuar tashmë prej 10 vitesh në Republikën e Kosovës.
3. Të marrë në konsideratë efektet praktike dhe ligjore të kësaj nisme, duke synuar një sistem ekzekutimi të efektshëm dhe të besueshëm, e jo të paragjykuar apo të dobësuar, ashtu si është lënë deri më sot.



4. Të pranojë dhe shqyrtojë një draft-propozim të propozuar nga profesionistët e fushës së ekzekutimit të detyruar, Përmbauesit Gjyqësorë Privatë.

Ne nuk mund të pranojmë më anatemimin e profesionit të përmbauesit gjyqësor privat nga pavëmendja e ligjvënësit apo e vullnetit qeverisës. Shërbimi përmbaues gjyqësor nuk mund të trajtohet me si një segment fundor dhe i parëndësishëm i sistemit të drejtësisë, por si një hallkë kyçe në garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe subjekteve ekonomike, si ura lidhëse mes Ligjit dhe Ekonomisë.

Është kjo arsyeja që, ne, Asambleja e Përgjithshme e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, mbështesim nismën për t'i dhënë përmbauesit gjyqësor kompetencën e nevojshme për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, duke i siguruar kështu sistemit gjyqësor një mekanizëm më të shpejtë dhe efikas të mundshëm në ekzekutimin e vendimeve të gjykatave dhe titujve ekzekutivë.

Është kjo arsyeja që, sa kohë është menduar decentralizimi i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga aktorë të tjerë jashtë gjykatës, asnjë subjekt tjetër i fushës së profesioneve të lira juridike profesionale nuk mund të jetë më i përshtatshëm, profesionist dhe kompetent sesa përmbauesi gjyqësor.

Ne i kërkojmë Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit për Çështjet Ligjore të orientohet dhe vendosë mbi standardet më të mira ndërkombëtare sa i përket nismës së decentralizimit të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, duke kthyer sytë së pari nga praktika e konsoliduar, tashmë e provuar si sukses që flet shqip, ajo në Kosovë.

Në këtë kuadër, ju përcjellim për shqyrtim një draft-propozim të detajuar, me qëllim përsosjen e nismës së datës 31.12.2024, për ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile.

Kjo kërkesë u miratua sot më 1.2.2025, nga Asambleja e Përgjithshme e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Vendi i zhvillimit të Asamblesë: Ministria e Drejtësisë

Datë: 1.2.2025

Pjesëmarrja: 73 përmbaues

